



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritit dhe Projekteve

THIRRJE PËR EKSPERT KOMBËTAR

NË QENDRËN E PËRBASHKËT KËRKIMORE NË ISPRA ITALI

Komisioni European ka shpallur njoftimim për Ekspert Kombëtar për Qendrën e Përbashkët Kërkimore (Joint Research Center, JRC) në Institutin e Energjisë dhe Transportit, në Ispra të Italisë.

Detyrat e Ekspertit Kombëtar janë:

- Hulumtimi dhe identifikimi i teknologjive të sigurisë dhe praktikave të administrimit të rrezikut në industrinë e naftës dhe gazit në det të hapur.
- Hulumtimi dhe inventarizimi i pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë për instalimet fikse dhe të lëvizshme, për shpime eksploruese në det të hapur dhe prodhime.
- Analiza e zbatueshmërisë së legjislacionit të sigurisë së produktit të BE-së.

Kriteret e përzgjedhjes

- Diplomë universitare apo e doktoraturës në fushën e inxhinierisë përkatëse apo fusha të shkencave fizike;
- Përvojë profesionale të paktën pesë vjet në fushën e sigurisë teknike të eksplorimit në det të hapur dhe prodhimin e hidrokarbureve apo sigurinë e sistemeve të lidhura me këtë industri.

Kandidatët duhet të dërgojnë aplikimin e tyre sipas formatit Europass CV <http://europass.cedefop.europa.eu/en/documents/curriculum-vitae> në gjuhën angleze, franceze ose gjermane deri më 25 mars 2014 **vetëm pranë Misionit Diplomatik të Republikës së Shqipërisë** pranë BE-së në Bruksel, në adresën mission.eu@mfa.gov.al Çdo aplikim duhet të specifikojë referencën "JRC.F.3". Misioni më pas do t'i përcjellë aplikimet në shërbimet kompetente të Komisionit brenda afatit të caktuar.

Për më tepër informacion mbi procedurën e regjistrimit dhe përzgjedhjes, kandidatët e interesuar duhet t'i referohen adresës në vijim:

<http://ec.europa.eu/dgs/jrc/index.cfm?id=6520>